



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:265708

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06313618

**C-IV-14-7502**

*Ankuesi:*

**M L I S** nga Prizreni.

**Kundër**

*Pala kundërshtare:*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.14 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Nuk caktohet taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.15 dhjetor 2014, ankuesja parashtrij ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likudimit nr.PRN125-1069 dt.01 dhjetor 2014 me të cilin kishte kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 11,439.40€.

Me dt.04 korrik 2024, gjykata lëshoi vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore. Ankuesja u njoftua se nëse nuk e bënë pagesën e taksës gjyqësore në afat prej 15 ditëve atëherë ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Ankuesja e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me dt.16 korrik 2024, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.

Sipas neni 76 par.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për

të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Ankuesja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës, për arsye se nuk është paguar taksa gjyqësore përkundër vërejtjes së pranuar, konstatoi se ankesa duhet të konsiderohet e tërhequr.

Me dt.04 korrik 2023, Gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesja që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk përgjigjet në vërejtjen e lëshuar nga gjykata. Ankueses është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore, por që nga koha e pranimit të së vërejtjes me dt.16 korrik 2024 nuk i është përgjigjur gjykatës.

Duke u bazuar në nenin 10 par.10.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 të KGJK-së, në përputhje me paragrafin 4 të Vendimit të KGJK-së nr. 25 të datës 5 mars 2014 por edhe bazuar si dhe nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, i cili ka hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, Paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i vërejtjes së gjykatës për t’ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar.

Megjithatë, paditësi mund t’i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ajo është e liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndhimës Ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndhimë Juridike.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 par. 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur.

Ndërsa neni 5 par.5.2 parasheh që: "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Rrjedhimisht, neni 253 par.5 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se: 'Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr'.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesja nuk ka interes për çështjen juridike të saj dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja  
**Hajrie Shala**